REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK/OPŠTINA JUNIK/MUNICIPALITY OF JUNIK
02/Nr. Prot 6-02/14-2269
Nr. i faq.
Data 03/04/2026

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK– MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës
Nr. 002/22
Datë: 31.03.2026

Në bazë të nenit 12,40 dhe 68 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Ligji Nr.03/L-040, GZRK numër 28/2008), nenit 7 dhe 8 të Ligjit Nr.04/L-164 për Financimin e Programeve të veçanta të Banimit, nenit 5,6dhe 8 të Ligjit Nr.04/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së paluajtshme të Komunës (në funksion të projekteve të strehimit), si dhe dispozitave përkatëse të legjislacionit për strehim social dhe mirëqenie sociale në Republikën e Kosovës, Kuvendi i Komunës së Junikut në mbledhjen e tijë të rregullt të mbajtur më 31.03.2026 nxjerrë:

VENDIM

për inicimin e procedurave për hartimin e planit tre-vjeçar për strehim local në Komunën e Junikut (2026 – 2028)

I. Me këtë vendim inicohen

procedurat për hartimin e Planit tre-vjeçar për strehim lokal në Komunën e Junikut për periudhën 2026-2028, në përputhje me politikat shtetërore për strehim social dhe zhvillim të qëndrueshëm lokal.

II. Planit tre-vjeçar për strehim lokal do të përfshijë:

- Identifikimin e nevojave për strehim në Komunë,
- Kategorizmin e përfituesve sipas legjislacionit në fuqi për strehim social,
- Planifikimin e projekteve për ndërtim, renovim dhe subvencionim të banimit,
- Planifikimin e shfrytëzimit të pronës komunale për qëllime strehimi,
- Burimet financiare (buxheti komunal, grantet dhe donacionet),
- Mekanizmat për zbatimin dhe monitorimin e planit.

III. Autorizohet Kryetari i Komunës që brenda afatit prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, të themelojë Grupin punues për hartimin e Planit tre-vjeçar për Strehim Lokal.

IV. Grupi punues është i obliguar që draftin e Planit tre-vjeçar për strehim Lokal ta përgatisë dhe ta dorëzojë për shqyrtim në Kuvendin Komunal brenda afatit prej 90 ditësh nga themelimi i tijë.

V. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

1. MAPL,
2. Kryetari i Komunës së Junikut,
3. Shërbimi i Kuvendit të Komunës,
4. Drejtoria e SHMS-së në Komunën e Junikut,
5. Arkivi i Komunës së Junikut.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Leonard Gollumi